



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

Data 04.06.2024

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
TE VEÇANTA PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Rikonstruksion i rrugeve rurale dhe veprave te artit te  
Bashkise Librazhd ”**

**Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Ndertim kanalesh-45247110-4**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 9,995,062.82 (nente milion e nenteqind e nentedhjete e pese  
mije e gjashtedhjete e dy pike tetedhjete e dy ) leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**A. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë :**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi :** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme) :**

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël **se vlera e fondit limit që prokurohet.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sidhebazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, sidheLigjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

**2.2.2** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël **se vlera e fondit limit që prokurohet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

**2.2.3.** Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2023**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP sidhenëligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore” indryshuar, neni 5, pika c.

### **2.3 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:**

**a-** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

#### **Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a.** punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **100%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

#### **ose**

- b.** punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

#### **-Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:**

**-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:** Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9) i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Faturat Tatimore, Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:** Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: - Kontratë punimesh, -Situacionin përfundimtar, -Akt-kolaudimin, -Çertifikatën e marrjes në dorëzim- Faturat tatimore për çdo situacion punimesh.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Investitorit.

#### **Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
  - *N.P-1 (Punime germimi e toke)* *Niveli A*
  - *N.P-3 (Rikonstuksion dhe mirembajtje,)* *Niveli A*
  - *N.P-4 (Rruge,autostrada,mbikalime,)* *Niveli A*
  - *N.P-12 (Punime te inxhinjerise se mjedisit)* *Niveli A*
- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
  - *N.S.-8 (Ndertime parafabrikat, beton arme,)* *Niveli A*
  - *N.S.-10 (Shtresa dhe mbistruktura infrast,)* *Niveli A*
  - *N.S.-18 (Punime topogjeodezike,)* *Niveli A*

sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008).Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t’i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim/ kontratën e bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojne veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku jane te përcaktuar kategorite perkatese dhe niveli i klasifikimit per licensat e subjekteve qe ushtrojne veprimtari ne fushen e ndertimit.

*Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:*

### **2.3.2. Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar per keto punime.**

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndertimi 1(një)
  - Inxhinier Mjedisi 1(një)
  - Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder 1(një)
  - Inxhinier Gjeolog 1(një)
- Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten:Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*),librezë pune, C.V.

**Argumentimi :** Kerkesat e mesiperme jane vendosur ne zbatim te ligjit 162/2020 Per prokurimin Publik dhe VKM- nr. 285 datw 19.05.2021 “ Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” neni 39 pika 6 Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- a) Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
- b) Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

### 2.3.3 Stafi Ndhimes/Mbeshtetes/Certifikimet ose Kualifikimet mbeshtetese:

- a) **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për ***”Pergjegjes per sigurimin dhe kontrollin e cilesise sipas ISO 9001:2015”***, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.  
(Për pergjegjesin e kontrollit te cilesise duhet te paraqitet Certifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit).
- b) **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si ***”Pergjegjës për mbrojtjen dhe administrimin/menaxhimin e dëmeve në mjedis”***, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.  
(Për ekspertin e Demit ne Mjedis duhet te paraqitet Certifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit).
- c) **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit

për *"Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne Pune"*, *"Pergjegjes per sigurinë"*, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,

- d) Operatori ekonomik duhet te ketë në stafin e tij, **1(nje)** persona te certifikuar per *"Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave"*, te cilet duhet te figurojne ne listepagese minimalisht per 3 (tre) muajt e fundit).
- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1(nje)** mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet te jete detyrimisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit.

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, mjafton qe ky kriter te plotesohet bashkerisht.*

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 26 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", pika 6 "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese", si më sipër kërkuar.**

Argumentimi: Sipas pikës 2.3.7, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej mesatarisht **45 (dyzete e pese)** personave, për periudhën **3 muajt e fundit.**

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punetore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punetore te nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.629, date 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve per

objektin e prokurimit, orëve të punës, afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë punëtore janë përllogaritur stafi teknik dhe inxhinierik si dhe stafi administrativ.

**2.3.5** Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (për sistemin e menaxhimit të mjedisit)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001-2018 (për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)**, ose certifikatën ekuivalente, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 37001:2016 (për sistemin e menaxhimit të Anti-Ryshfetit)**, ose certifikatën ekuivalente, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **BS ISO 39001:2012 (për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor)** e vlefshme,

Argumentimi : Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit.

**2.3.8** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme” ose të ketë kontratë shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri të licensuara. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislativonin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”). Licenca duhet të shoqërohet me akt miratimin.

**2.3.6 a)** Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga QKB me **Licencë I.2.A "Shërbime Ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile" për sistemet e ekspertizës teknike kundër zjarrit.**

**b)** Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga QKB me **Licencë III.2.A(1+2) "Shërbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis"-** Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

**c)** Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga QKB me **Licencë III.2.B) "Shërbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis"-** Veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis-Grumbullim dhe transport i mbetjeve të Ngurta.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj licensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makinerite të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , bazuar ne tipologjine e zerave te preventivit , analizave perkatese te zerave te preventivit etj, nga specialistet perkates te inxhinierie, nga grupi i punes per perllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te vecanta teknike te kualifikimit .

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” si edhe nga praktika te meparshme te ngjashme. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 11(njëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	1 copë	Pronësi ose me qera
Dumper kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome (ose Eskavator) me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Mini Fadrome/ Bobcat	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	2 copë	Pronësi ose me qera



RTV / Rimorkiator ose Karrotrec	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues (ngjeshes)	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak me karb. ose elekt., per ngjeshje	1 copë	Pronësi ose me qera
Pllake vibruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	1 copë	Pronësi ose me qera
Prozhektore kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	1 copë	Pronësi ose me qera
<b>GPS</b> per rlevime matje/azhornime topografike	1 copë	Pronësi ose me qera
<b>Total Station</b> per rlevime matje/azhornime topografike	1 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 45copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 2copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 3copë
- Uniforma/Jelek pune 45cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15copë

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.